

URDHËR
Nr. 233, datë 5.10.2023

**PËR MIRATIMIN E PËRKTHIMIT NË GJUHËN SHQIPE TË NDRYSHIMEVE
NË STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT “PASQYRA E
FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE (SNK 7)”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25, datë 10.5.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit “Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare (SNK 7)”.
2. Ndryshimet e SNK 7 “Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare”, të publikuara në maj 2023, kanë datë efektive 1 janar 2024, por lejohet zbatimi i mëhershëm i tyre.
3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË
Ervin Mete